

Komunal për Integritime Evropiane në takimin e mbajtur më 12 qershor 2008 në Brod të KK të Dragashit dhe përkrahjes së dhënë nga Asociacioni i Komunave të Kosovës me seli në Prishtinë, Kolegjiumi i Zyrtarëve Komunal për Integritime Evropiane, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2008 miratoi:

## **RREGULLOREN E PUNËS SË KOLEGJIUMIT TË ZYRTARËVE KOMUNAL PËR INTEGRIME EVROPIANE**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

- 1.1 Me këtë rregullore përcaktohet organizimi dhe mënyra e punës së Kolegjiumit të Zyrtarëve Komunal për Integritime Evropiane (në tekstin e mëtejme : Kolegjiumi)
- 1.2 Çështjet dhe pytjet me rëndësi nga fushëveprimi i Kolegjiumit shqyrtohen në kolegjium. Kolegjiumi jep mendime dhe propozime veçanërisht për :
- 1.3 Ndihmën që do t'i bëhet Kuvendit të Komunës, kryetarit dhe trupave ndihmëse (komiteteve) në sigurimin e të gjitha informative dhe raporteve për proqesin e integritimeve evropiane.
- 1.4 Ndihmën në zbatimin e vendimeve nga ana e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës, udhëzimeve të lëshuara nga ministritë, rregulloreve dhe urdhëresave administrative të miratuara nga Institucionet Qendrore të Kosovës që kanë të bëjnë me proqeset e Integritimit evropian.  
Propozon politika për sa i përket proqesit për integritime evropiane nga fusha e kompetencave të Komunës

### **2 PËRBËRJA E KOLEGJIUMIT**

#### **Neni 2**

- 2.4 Kolegjiumin e përbëjnë zyrtarët komunal (nga një për komunë) për integritime evropiane të
- 2.5 komunave të Kosovës.
- 2.6 Mandati i anëtarit të kolegjiumit do të varet nga kohëzgjatja e kontratës së tij apo saj – si
- 2.7 zyrtar për integritime evropiane.
- 2.8 Kolegjiumi i zyrtarëve për integritime evropiane ka Bordin e vet të përbërë nga 7 anëtar.

- 2.9 Bordin e udhëheq kryetari i Bordit të Kolegjiut të Zyrtarëve Komunal për Integritime Evropiane, ndërsa në mungesë të tij /saj me Kolegjiut udhëheq zëvendëskryesuesi ose një person i caktuar nga Bordi.

Puna e kolegjiut realizohet përmes takimeve të cilat thirren dhe organizohen nga ana e kryesisë së Kolegjiut.

Kolegjiut i zyrtarëve për integritime evropiane duhet të takohet së paku 10 herë në vit.

### **3 ORGANIZIMI DHE THIRRJA E MBLEDHJEVE TË KOLEGJIUT**

#### **Neni 3**

- 3.4 Kryetari i kolegjiut apo zëvendëskryetari fton anëtarët e kolegjiut, duke bërë të ditur agjendën për diskutim së paku pesë ditë para se të mbahet mbledhja.
- 3.5 Takimet e kolegjiut duhet të kenë kuorumin e nevojshëm, i cili kualifikohet i mjaftueshëm kur në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të kolegjiut të zyrtarëve për integritime evropiane.
- 3.6 Vendimet merren me shumicë të votave të anëtarëve prezent.

### **4 UDHËHEQJA E PUNËS DHE VENDOSJA NË MBLEDHJE**

#### **Neni 4**

- 4.4 Mbledhjet e kolegjiut sipas kësaj rregullore i udhëheq kryetari ose në mungesë të tij zëvendësi i tij apo njeri nga anëtarët e Bordit të Kolegjiut.
- 4.5 Para fillimit të mbledhjes, kryetari vërteton numrin e anëtarëve që janë prezent dhe të atyre që mungojnë dhe i njofton të pranishmit se në mbledhje prezantojnë shumica e anëtarëve dhe se mund të merren vendime të plotfuqishme.

#### **Neni 5**

- 5.1 Kryetari i kolegjiut e hap mbledhjen duke njoftuar të pranishmit se a pajtohen me rendin e ditës të propozuar. Pas caktimit të rendit të ditës, fillon mbledhja sipas pikave të rendit të ditës.

## **Neni 6**

- 6.1 Anëtarët e Kolegjiut marrin pjesë në diskutim për të gjitha pikat e rendit të ditës, kërkojnë shpjegime, shtrojnë pyetje dhe kërkojnë përgjigje nga referuesit.

## **Neni 7**

- 7.1 Shqyrtimi i pikave të rendit të ditës udhëhiqet veç e veç, sipas rregullit së pari në parim e pastaj në veçanti.
- 7.2 Mënyrën e udhëheqjes së shqyrtimit e propozon kryesuesi. Kryesuesi mund të propozoj kohëzgjatjen e shqyrtimit.

## **Neni 8**

- 8.1 Askush nuk mund ta marr fjalën në diskutim para se t'ia japë fjalën kryesuesi, të ndërhyjë në fjalë pjesëmarrësit në diskutim, apo në ndonjë mënyrë të pengoj punën e mbledhjes.
- 8.2 Kryesuesi ka të drejtë që anëtarit, i cili e pengon punën normale të mbledhjes, t'ia japë vërejtje, t'ia marrë fjalën e në rast të prishjes së rendit të ditës ta largojë edhe nga mbledhja.

## **Neni 9**

- 9.1 Diskutimi sipas pikave të veçanta të rendit të ditës zgjatë sipas rregullës deri sa të mbarojnë diskutimet e të gjithë të paraqiturve.
- 9.2 Kryetari mbyll diskutimin dhe propozon që të kalohet në konkludime apo votime
- 9.3 Në bazë të propozimeve në material, mendimeve të paraqitura gjatë diskutimeve kryetari formulon përfundimet apo vendimet dhe të njëjtat i paraqet për votim.

## **Neni 10**

- 10.1 Për propozimet e vendimeve vendoset me votim të hapur, i cili bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa rezultatet e votimit vërtetohen me numrim.
- 10.2 Vendimi konsiderohet i aprovuar, nëse për atë deklarohen më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm.

## **5 PROQESVERBALI**

### **Neni 11**

- 11.1 Për punën e Kolegjiutit, në mbledhje mbahet procesverbali.
- 11.2 Proqesverbalin sipas rregullës e udhëheq anëtari të cilin e cakton kryetari në fillim të mbledhjes vetëm nëse në takim mungon Zyrtari për Kolegjiume nga AKK.
- 11.3 Proqesverbali mbi punën e kolegjiutit përmban të dhënat themelore, dhe atë; ditën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, shenjën dhe numrin e mbledhjes numrin e anëtarëve prezent të Kolegjiutit dhe jo prezent, personat e tjerë që prezantojnë, emrin e kryesuesit dhe emrin e proqesmbajtësit, rendin e përcaktuar të ditës, emrat e paraqitësve dhe pjesëmarrësve në diskutim me përmbajtje të shkurtër të diskutimit dhe rezultatet e votimit sipas pikave të veçanta, të rendit të ditës, mendimet e ndara të anëtarëve të Kolegjiutit, dhe çështjet tjera me rëndësi.
- 11.4 Në fund të çdo pike të rendit të ditës shënohet sipas rendit të formulimit, ashtu si e paraqet kryetari.
- 11.5 Proqesverbali përpunohet në original dhe në numër të mjaftuar.
- 11.6 Proqesverbali origjinal nënshkruhet nga kryetari dhe nga proqesmbajtësi dhe i njëjti ruhet me materialin tjetër të mbledhjes dhe ruhet në arkiv.
- 11.7 Proqesverbali u shpërndahet rregullisht anëtarëve të Kolegjiutit.

## **VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 12**

- 12.1 Çështjet që nuk janë rregulluar me këtë rregullore, rregullohen me vendime të veçanta të kolegjiutit dhe janë anekse të kësaj Rregullore.

**Neni 13**

13.1 Vendimet apo aktivitetet që mund të merren nga Kolegjiumi nëse janë në kundërshtim me statusin e AKK-së do të jenë të pavlefshme.

**Neni 14**

14.1 Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit dhe zbatohet nga dita e miratimit të saj.

**KRYETARI I KOLEGJIUMIT**

.....